



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KOMISIONI HETIMOR

“PËR KONTROLLIN E VEPRIMTARISË SË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE PUSHTETIT VENDOR, PËR TË VERIFIKUAR PËRDORIMIN E BURIMEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE PËR QËLLIME ELEKTORALE NË ZGJEDHJET E 25 PRILLIT 2021”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 79/2021

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

VLERËSIMI I TË DHËNAVE PARAPRAKE, QË PËRBËJNË PLAN PARAPRAK HETIMI DHE DEKLARIMI I HAPJES SË HETIMIT

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 11 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, ku specifikohet se: “4. *Kryetari deklaron qëllimin e ngritjes së komisionit, përcakton detyrat e komisionit, si dhe planin paraprak të hetimit*”, bashkëlidhur do të gjeni Planin Paraprak të Hetimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PLANI PARAPRAK I HETIMIT

I KOMISIONIT HETIMOR PËR KONTROLLIN E VEPRIMTARISË SË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE PUSHTETIT VENDOR, PËR TË VERIFIKUAR PËRDORIMIN E BURIMEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE PËR QËLLIME ELEKTORALE NË ZGJEDHJET E 25 PRILLIT 2021”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 79/2021

I. FAKTET DHE RRETHANAT E PREZANTUARA NË KËRKESË

Në kërkesën e depozituar nga 1/4 e deputetëve evidentohet se:

“Në datën 25 Prill 2021, në Shqipëri u zhvilluan zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, në të cilat mori pjesë edhe koalicioni PD-AN, pjesë e të cilit ishte Partia Demokratike. Partia Demokratike ka kontestuar publikisht procesin e këtyre zgjedhjeve të përgjithshme, të shtrirë në kohë përpara ditës së votimit, duke shprehur bindjen se në Shqipëri u zhvillua masakra më e rëndë zgjedhore që nga zgjedhjet e vitit 1991. Pjesë e këtij kontestimi, përveç deklaratave politike sistematike, kanë qenë edhe përdorimi i të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, duke përfshirë një numër të lartë ankesash, kallëzimesh penale dhe apelimesh gjyqësore, të shoqëruara nga mijëra fakte dhe dokumente.

Përveç fenomeneve kriminale të shtrira në të gjithë vendin të blerjes së votës përmes bashkëpunimit të ngushtë dhe të hapur me rrjetet kriminale, Partia Demokratike ka konstatuar edhe 9 rrethana konkrete të parregullsive të rënda të procesit zgjedhor, si më poshtë vijon:

- i. Përdorimi i të dhënave personale i 910.000 qytetarëve shqiptarë (patronazhistët) për presion ndaj votuesve dhe asgjësimin e fshehtësisë së votës;*
- ii. Pagesa e 125 milionë eurove nga fondet publike përgjatë fushatës zgjedhore për shpërblimin e dëmeve për mijëra familje që u prekën nga tërmeti i vitit 2019, në shkelje të ligjit, me qëllim blerjen e votave familjare nga familjet në nevojë;*
- iii. Dhënia e tenderave publikë dhe koncesioneve të mëdha, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së. Shuma rekord prej 505 milionë eurosh u regjistrua në fushën e prokurimit publik në muajt Nëntor-Dhjetor 2020 për një total prej 878 kontratash dhe prokurimesh publike, në krahasim me mesataren vjetore prej 116 milionë për të njëjtën periudhë zgjedhore të mëparshme.*
- iv. Shpenzimi i 120 milionë eurove nga bashkitë vendore për punë asfaltimi, fond i disbursuar nga Qeveria në periudhë zgjedhore për pushtetin vendor të kontrolluar nga e njëjta parti;*

- v. *Rritja e pagave të administratës publike me 63 milionë euro në periudhë zgjedhore për qëllime elektorale;*
- vi. *Punësimi i përkohshëm i 13.000 punonjësve të rinj në administratën publike në periudhë zgjedhore për qëllime elektorale;*
- vii. *Disbursimi i parakohshëm i fondit të ndihmës ekonomike prej 2.5 milionë euro dhe shtesa e paligjshme e 20.000 familjeve në programin e ndihmës ekonomike në periudhë zgjedhore për qëllime elektorale;*
- viii. *Legalizimi i më shumë se 10.000 ndërtesave informale në shkëmbim të votës familjare, si dhe shfrytëzimi i këtij procesi nga agjencitë qeveritare në funksion të plotë të kandidatëve të Partisë Socialiste;*
- ix. *Mbyllja e pajustificuar dhe e parregullt e kufijve shtetërorë me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, për të mos lejuar numrin e lartë të votuesve të diasporës shqiptare dhe të minoritetit grek të vinin të votonin në Shqipëri.*

Në datën 26 korrik 2021, Misioni i ODHIRIT publikoi raportin final mbi zgjedhjet e 25 prillit 2021. Në përmbledhjen ekzekutive të këtij raporti rikonfirmohet gjetja kryesore, e konstatuar prej tyre edhe në deklaratën paraprake, më 26 prill 2021, sipas të cilës: “Partia qeverisëse përfitoi avantazhe të rëndësishme nga të qenit pushtet, duke përfshirë edhe përmes kontrollit të administratave lokale dhe shpërdorimit të burimeve administrative. Kjo u amplifikua edhe nga mbulimi pozitiv i institucioneve shtetërore në media. Pretendimet për blerje votash nga partitë politike ishin të përhapura gjatë fushatës dhe një numër i lartë hetimesh u hapën në këtë drejtim”.

Kjo gjetje mbështetet në një paraqitje të detajuar të të dhënave në brendësi të raportit, që konfirmojnë gjithashtu parregullsitë e rënda, të evidentuara edhe nga Partia Demokratike, sic janë listuar më lart. Duke iu referuar raportit final të Misionit të ODHIR-it, vihet re se 9 rrethanat e konstatuara nga Partia Demokratike, janë grupuar në dy kategori. Më konkretisht:

1. *Lidhur me **keqpërdorimin e të dhënave personale**, Misioni i ODHIR në raportin final, në faqen 19, shprehet se: “Gjatë fushatës, përmes një rrjedhjeje informacioni, në domeinin publik doli një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afërsisht 900,000 qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre potenciale të votimit. Partitë e opozitës, Presidenti dhe shumë në media kërkuan një hetim nga SPAK në lidhje me keqpërdorimin e pretenduar të të dhënave personale të qytetarëve. Ndarja ose kombinimi i paautorizuar i të dhënave personale të votuesve për qëllimet e supozuara të angazhimit demokratik mund të konsiderohet shkelje e angazhimit për mbrojtjen e të drejtës për jetën private dhe familjare. Kjo mund të dëmtojë besimin e elektoratit, duke përfshirë edhe besimin të fshehtësia e votës së tyre.*
2. *Lidhur me **abuzimet për përfitime elektorale të fondeve publike për shpërblimin e dëmeve të tërmetit, për legalizimet dhe rritjen e punësimeve**, Misioni i ODHIR në raportin final, në faqet 18-19, shprehet se: “Ministrat vazhduan me angazhime zyrtare gjatë gjithë fushatës. Ata u shfaqën rregullisht në “vizita inspektimesh” të objekteve kyçe, si në qendrat e vaksinimit, me maska në fytyrë ose me bluza që lexonin “Nr. 12” (numri i*

PS-së në fletën e votimit), gjë që çoi në publicitet të konsiderueshëm dhe që përbëri aktivitet për qëllime fushate. Edhe Kryeministri inauguroi disa projekte madhore infrastrukturore gjatë fushatës. Këto lloj aktivitetesh i dhanë një avantazh të konsiderueshëm PS-së, gjë që ishte përforcuar tashmë edhe më shumë nga dominimi i PS-së në administratën lokale. Përveç kësaj, punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore, saktësisht në kohën para moratoriumit ndaj autorizimit të punësimeve të reja në administratën publike.

- 3. Media raportoi se pati një rritje të madhe në shpërndarjen e granteve nga bashkitë, miratuar javën para zgjedhjeve sipas programit përkatës të rindërtimit. Për shumë përfitues grantesh ka pasur gjithashtu një rritje të vlerës së shpërblimeve në cash të autorizuar nga bashkia. Disa bashkëbisedues të MkVZ-së së ODIHR-it i perceptuan këto shpërndarje grantesh si shpërdorim të burimeve shtetërore. MkVZ-ja e ODIHR-it mori edhe raportime të tjera, sipas së cilave u bënë përpjekje për të ndikuar në votim përmes sigurimit të stimujve, të tilla si lëshimi i lejeve që vërtetojnë ndërtimet e paligjshme. Këto raporte gjithashtu pretendonin se shumë nëpunës civilë, një grup i prekshëm nga presioni, ishin inkurajuar të votonin për partinë në pushtet.*

II. PLAN PARAPRAK HETIMI

A. Objekti:

Sipas vendimit nr. 79/2021 të Kuvendit, objekt i veprimtarisë së komisionit është:

1. Verifikimi i përdorimit të të dhënave personale për qëllime elektorale;
2. Verifikimi i përdorimit të fondeve publike për qëllime elektorale, duke përfshirë edhe shpërblimin e dëmeve nga tërmeti i vitit 2019;
3. Verifikimi i përdorimit të procesit të legalizimeve të ndërtimeve informale për qëllime elektorale;
4. Verifikimi i punësimeve në administratën publike për qëllime elektorale.

Hetimi do të synojë nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor, përfshirë garantimin e lirisë së votës, rritjen e besimit të publikut, mirëmenaxhimin e buxhetit të shtetit.

Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, vecanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur punës së organeve të drejtësisë.

Hetimi do të realizohet në drejtim të sqarimit të mënyrës së zbatimit të ligjit, identifikimit të përgjegjësive të organeve apo personave zyrtarë përkatës, në përdorimin e burimeve të administratës publike në funksion të zgjedhjeve të 25 prillit 2021, analizimit të gjetjeve për të përgatitur rekomandimet për ndërhyrje ligjore e administrative për parandalimin apo eliminimin plotësisht të tyre në të ardhmen.

B. Detyrat e Komisionit dhe veprimet e tij:

Detyrat e Komisionit janë:

- (1) Kontrolli i veprimeve dhe mosveprimeve të organeve publike të përfshira në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave personale, përfshirë, por pa u kufizuar në, Agjencinë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- (2) Kontrolli i veprimeve të organeve publike sa i përket dhënies së shpërblimeve, kompensimeve, bonuseve, përfshirë, por pa u kufizuar në, shpërblimet për dëmet e tërmetit të vitit 2019, dhënien/rritjen e ndihmës ekonomike, pensioneve, bonuset e qirasë, rimbursimet e fermerëve, tollonët e karburantëve;
- (3) Kontrolli i veprimeve të organeve publike sa i përket fondeve të akorduara për kontratat publike (tendera, koncesione), punët publike (shtrime rrugësh, ndërtim dhe rindërtim veprash publike);
- (4) Kontrolli i veprimeve të organeve publike sa i përket numrit të legalizimeve të ndërtimeve informale dhe lejeve të ndërtimit, përfshirë, por pa u kufizuar në, veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kryetarëve të Bashkive dhe Këshillit Kombëtar të Territorit;
- (5) Kontrolli i veprimeve të organeve publike sa i përket numrit të punësuarve në administratën publike, pagat, shpërblimet dhe bonuset, me qëllim tjetërsimin e vullnetit të tyre në zgjedhjet e 25 Prillit.

Për përmbushjen e këtyre detyrave, komisioni:

- 1) miraton planin e hetimeve;
- 2) mbledh të dhëna për çështjen, të cilat mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, por që njihen publikisht;
- 3) thërret dëshmitarë për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen;
- 4) në shërbim të hetimeve mbi çështjen, administron dokumente zyrtare, si dhe të dhëna të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e hetimeve;
- 5) për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen, thërret ekspertë të njohur nga gjykata për fusha të ndryshme.

Në mbështetje të neneve 14/b, 15/1 dhe 17 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 79/2021, do të kërkohet nga disa institucione shtetërore, që të vendosin në dispozicion informacionet/dokumentat që disponojnë për objektin e hetimit. Konkretisht, do të kërkohen ndër të tjera, por pa u kufizuar vetëm në to, dokumentet apo informacionet e mëposhtme:

1. Informacione apo dokumente të dërguara nga Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për numrin e procedimeve penale, lidhur me krimet zgjedhore dhe fazën e tyre;
2. Informacione apo dokumente të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme për numrin e procedimeve penale, lidhur me krimet zgjedhore dhe fazën e tyre;

3. Informacione apo dokumente të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për numrin e shtetasve të ndaluar, të arrestuar dhe numrin e rasteve të referuara për krime zgjedhore;
4. Informacione apo dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit mbi gjendjen e rezervave të shtetit në depozitat qendrore dhe lokale për cdo muaj në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
5. Informacione apo dokumente nga Inspektoriati Qëndror dhe të gjitha inspektoriatet e tjera që veprojnë në Shqipëri për numrin e inspektimeve të kryera, numrin e gjobave dhe sanksioneve të vendosura, numrin e sanksioneve/gjobave të revokuara me vendim administrativ/gjyqësor në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021, të ndarë sipas muajve;
6. Informacione apo dokumente nga Agjencia e Prokurimeve Publike për numrin e tenderave, koncesioneve, PPP-ve për periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021, të ndarë sipas muajve;
7. Informacione apo dokumente nga bashkitë dhe Këshilli Kombëtar i Territorit për numrin e lejeve të ndërtimit të dhënë në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021, të ndarë sipas muajve;
8. Informacione apo dokumente nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për numrin e lejeve të legalizimeve në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021, të ndarë sipas muajve;
9. Informacione apo dokumente nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin për numrin e banesave të ndërtuara/rindërtuara, për të cilat janë dhëne celësat e banesave në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
10. Informacione apo dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për numrin e shtetasve shqiptarë që ndryshuan adresat e banimit në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
11. Informacione apo dokumente nga Departamenti i Administratës Publike për numrin e punonjësve të institucioneve publike, vendore apo qendrore, në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
12. Informacione apo dokumente nga 61 bashkitë e vendit, agjencinë e varësisë dhe kompanitë publike, për numrin e punonjësve në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
13. Informacione apo dokumente nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 61 bashkitë e vendit lidhur me numrin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike, apo shtesa të përhershme/përkohshme të masës së ndihmës, në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
14. Informacione apo dokumente nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe bashkitë Durrës, Tiranë, Kavajë, Lezhë, Rrogozhinë, Vorë, Krujë, Lac dhe Mirditë për shpërblimet e dhëna familjeve të prekura nga tërmeti, në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
15. Informacione apo dokumente nga Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar lidhur me fazën e hetimeve lidhur me bërjen publike të të dhënave personale të 910 mijë qytetarëve të Tiranës;
16. Informacione apo dokumente nga Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile lidhur me mbledhjen, përpunimin, administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

17. Informacione apo dokumente nga Ministria e Brendshme lidhur me numrin e shqiptarëve me të drejtë vote që jetojnë jashtë Shqipërisë, vecanërisht atyre që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut;
18. Informacione apo dokumente nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbi numrin e shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin e RSH-së në periudhën 19.04.2021 – 25.04.2021, nga Republika e Greqisë dhe Maqedonia e Veriut; listën e plotë të këtyre personave;
19. Informacione apo dokumente nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me rimbursimet, tollonat e karburantëve dhënë fermerëve në periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021;
20. Çdo informacion tjetër të nevojshëm për përmbushjen e detyrave nga ana e Komisionit, sipas objektit të punës së Komisionit.

Komisioni Hetimor përveç marrjes së informacioneve zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të përdorë të gjitha metodat e hetimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë kqyrjen, kontrollin apo sekuestrimin e akteve pranë institucioneve përgjegjëse.

Nga ana tjetër, në kuadër të analizës së plotë mbi këtë çështje, do të thirren për të dëshmuar në Komisionin Hetimor, personat apo funksionarët publik të mëposhtëm:

Emër, Mbiemër	Funksioni
Edi Rama	Kryeministër i Shqipërisë
Arben Ahmetaj	Ministër i Shtetit për Rindërtimin
Bledar Cuci	Ministër i Punëve të Brendshme
Belinda Balluku	Ministër i Infrastrukturës/Energjisë
Ogerta Manastirliu	Ministër i Shëndetësisë/Mbrojtjes Sociale
Frida Krifca	Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Erion Veliaj	Kryetar i Bashkisë Tiranë
Emiriana Sako	Kryetare e Bashkisë Durrës
Arben Kraja	Drejtues i SPAK
Olsian Cela	Prokuror i Përgjithshëm
Ardi Veliu	Ish-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Gledis Nano	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Artan Lame	Drejtor i Përgjithshëm i ASHK
Linda Karcanaaj	Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI
Shkëlqim Hajdari	Inspektor i Përgjithshëm i Inspektoriatit Qëndror
Reida Kashta	Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimeve Publike
Sokol Zaimi	Drejtor i Rezervave Materiale të Shtetit
Bledar Doracaj	Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile

Albana Kociu	Drejtor i Departamentit të Administratës Publike
Adrian Cela	Administrator i OSHEE Group
Laert Duraj	Ish-Drejtor i Përgjithshëm i Postës Shqiptare
Besnik Dervishi	Komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
<p>- Komisioni rezervon të drejtën që ne Planin e Hetimit të thërras për të dëshmuar cdo person apo funksionar tjetër që ka dijeni rreth objektit të hetimit, dhe që rezulton i përfshirë në këtë çështje nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar.</p>	

C. Afati i zhvillimit të hetimeve dhe përfundimit të tij:

Veprimet	Afati maksimal
Mbledhja e dokumentacionit	Brenda datës 29 Tetor 2021
Shqyrtimi paraprak i dokumentacionit dhe vlerësimi i nevojës për dokumentacion shtesë – Miratimi i Planit të Hetimit	Brenda datës 14 Nëntor 2021
Pyetja e dëshmitarëve	Brenda datës 30 Nëntor 2021
Analizimi i akteve dhe dokumentave	Brenda datë 15 Dhjetor 2021
Shqyrtimi përfundimtar dhe nxjerrja e konkluzioneve të hetimit – Mbyllja e Hetimit	Brenda datës 5 Janar 2022
Prezantimi i Raportit Final të Komisionit	Brenda datës 12 Janar 2022

Hetimi konsiderohet i hapur dhe Komisioni do të përfundojë veprimtarinë e tij brenda afatit të caktuar me vendim të Kuvendit (14 Janar 2022).

D. Hartimi i Planit të Hetimit:

Mbi bazën e Planit Paraprak të Hetimit, Kryetari i propozon Komisionit për miratim projektvendimin “Për miratimin e Planit të Hetimit të Komisionit Hetimor” brenda afateve të parashikuara nga ligji. Me qëllim hartimin e Planit të Hetimit dhe realizimit të veprimeve të përcaktuara në këtë Plan Paraprak Hetimi, Komisioni, nëpërmjet Kryetarit, mund të kërkojë të dhëna dhe dokumente të tjera nga titullarët e institucioneve publike, si dhe të kryejë cdo veprim sipas nenit 15 dhe 17 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”.

KRYETARI

Enkelejd ALIBEAJ